

**Vendim nr. 79 datë 13.04.2023**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

|                 |           |
|-----------------|-----------|
| Elsa Toska,     | Kryesuese |
| Illir Toska,    | Anëtar    |
| Genti Ibrahimi, | Anëtar    |

në datën 13.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (K) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **KRENAR TAHIRI**

**OBJEKTI:** **Pavlefshmëria e titujve ekzekutivë, vendimit nr. 2054, datë 15.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 331, datë 24.03.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë.**  
**Shpërblim dëmi pasuror, moral dhe shëndetësor.**

**BAZA LIGJORE:** Nenet 41-44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se me kontratën e shitblerjes së datës 21.06.1996, kërkuesi Krenar Tahiri dhe shtetasi C.R. kanë blerë një ndërtesë dykatëshe magazinë, me sipërfaqe 320 m<sup>2</sup>, të ndodhur në qytetin e Vlorës.

2. Me vendimin nr. 915, datë 18.05.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, mbi bazën e kërkesëpadi së bashkëpronarit C.R., sendi magazinë është ndarë në natyrë në këtë mënyrë: pjesa veriore e objektit në të dyja katet i është lënë paditësit C.R., ndërsa pjesa jugore i është lënë kërkuetit Krenar Tahiri (i padituri). Për ekzekutimin e këtij vendimi është investuar Zyra Përmbartimore Vlorë.

3. Në datën 01.10.2014 kërkuesi i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesëpadi me objekt lirim dhe dorëzimin e sendit magazinë, 1/2 e sipërfaqes së pasurisë nr. 4/94, nr. 1737 regjistri hipotekor, mbi të cilin pretendon të drejta pronësie si bashkëpronar, duke pretenduar se është zënë forcërisht nga pala e paditur A.SH. Ai ka kërkuar edhe detyrimin e palës së paditur t'i kthejë pajisjet e linjës teknologjike si dhe pajisjet e zyrës në vlerën 250,000 euro, shpenzimet e montimit të impiantit me specialist të huaj në vlerën 20,000 euro, si dhe vlerën prej 300,000 lekësh që ka qenë në zyrë.

4. Me vendimin nr. 2054, datë 15.12.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadi së. Në vlerësimin e gjykatës *“paditësi nuk provoi se aktualisht është pronar i magazinës dykatëshe apo të ndonjë pjese të saj. Pjesë e objektit të kësaj padie është kërkitimi i pajisjeve të linjës teknologjike, të pajisjeve të zyrës dhe të sasisë prej 300 mijë lekësh, për të cilat nuk u paraqit asnjë provë që të provonte se këto sende ndodhen pranë të paditurit. Gjithashtu, nuk u paraqit ndonjë provë për ekzistencën e tyre dhe ky kërkitim, pavarësisht se është shënuar në objektin e padisë, nuk u debatua nga paditësi gjatë gjykimit. [...] Gjykata, nga thëniet e paditësit, arrin në konkluzionin se paditësi Krenar Tahiri nuk është dakord me vendimin për ndarjen e sendit të cilin e ka pasur në bashkëpronësi me shtetasin C.R. Pretendimet për këtë paditësi ka pasur mundësi t'i ngrejë në gjykimin e zhvilluar për pjesëtimin e sendit në të cilin ai ka pasur cilësinë e palës së paditur. Si rrjedhim, të gjitha kërkitimet në lidhje me këtë fakt përbëjnë “gjë të gjykuar” dhe nuk mund t'i nënshtrohen rishtazi një gjykimi tjetër përderisa vendimi për ndarjen e sendit ka marrë formë të prerë dhe është ekzekutuar” (shih faqet 4 dhe 6 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë).* Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në gjykatën e apelit.

5. Me vendimin nr. 331, datë 24.03.2016, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2054, datë 15.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

6. Në datën 06.02.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të mësipërm, i cili, pasi është plotësuar me aktet e kërkuara, është regjistruar në datën 17.02.2023.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

- 7.1. Nëpërmjet vendimit nr. 915, datë 18.05.2005, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka bërë pjesëtimin e magazinës në 1/2 pjesë, ku pala paditëse e kishte ndarë vetë objektin, ndërsa makineritë e rënda të lavanderisë industriale dhe kaldaja mbetën në pjesën e paditësit. Nëpërmjet dy ekspertizave grafike si dhe asaj të bërë nga gjykata me këqyrje në vend, është konstatuar prania e makinerive teknologjike në anën e palës paditëse.
- 7.2. Edhe pse rekursi në Gjykatën e Lartë është paraqitur në datën 21.04.2016, ai nuk është shqyrtuar ende, edhe pse kanë kaluar 7 vjet, pavarësisht se kërkuesi ka bërë kërkesa të njëpasnjëshme për përsheptimin e procesit.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

#### A. Për legjitimimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si

dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

9. Kërkuuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Një kriter tjetër paraprak që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Për plotësimin e këtij kriteri, kërkuuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi. Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kolegji vëren se në objektin e ankimit kushtetues individual, kërkuuesi ka kërkuar pavlefshmërinë e titujve ekzekutivë, vendimeve nr. 2054, datë 15.12.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe nr. 331, datë 24.03.2016 të Gjykatës së Apelit Vlorë, të cilat janë kundërshtuar prej tij në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë dhe ende nuk rezulton të ketë një vendim përfundimtar të asaj gjykate. Në këto kushte, për sa kohë që Gjykata e Lartë nuk është shprehur për vendimet gjyqësore që kanë shqyrtuar padinë e kërkuarit, Kolegji vlerëson se në lidhje me kërkesën në shqyrtim kërkuuesi nuk ka shteruar mjetet juridike që ofron sistemi i zakonshëm gjyqësor.

12. Edhe në lidhje me pretendimet në përmbajtje të kërkesës që kanë të bëjnë me tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, Kolegji vëren se edhe pse kërkuuesi është shprehur se ka bërë kërkesa të njëpasnjëshme për përshpejtimin e procesit gjyqësor, ai nuk ka paraqitur bashkëlidhur kërkesës asnjë fakt ose dokument që të provojë se i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave, pra që

ka shteruar mjetet procedurale të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe se këto mjete, për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, nuk kanë rezultuar efektive për mbrojtjen e së drejtës së tij për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, si një nga aspektet e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës.

13. Për sa më sipër, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, përpara vënies në lëvizje të gjyimit kushtetues. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

14. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.